

Të rinjtë në Kosovë

“Të rinjtë janë e ardhmja e këtij vendi”, është fjali që shumë shpesh e dëgjojmë. Kjo fjali edhe tregon për shkallën e interesimit të shoqërisë e posaçërisht të qeverisësve për rini, ngaqë të rinjtë janë edhe e tashmja e këtij vendi. Në bazë të kësaj mund të shohim se të rinjtë në shoqërinë kosovare kurrë nuk janë parë si partnerë serioz në zgjidhjen e problemeve sociale, ekonomike dhe politike por janë parë vetëm si pjesë e problemit të përgjithshëm.

Në kohën në të cilën po jetojmë të rinjtë janë ata të cilët po i formësojnë rrjedhat e gjithëmbarshme shoqërore. Të rinjtë karakterizohen si komponentë e rëndësishme e zhvillimeve shoqërore, si forcë shtytëse në reformat politike dhe ekonomike të një vendi.

Në shoqëri kosovare mbi gjysma e popullsisë i takojnë moshës nën 24 vjeç, me shkallën më të lartë të natalitetit në Evropë, gjë që lë të kuptohet se të rinjtë janë aset shoqëror i çmueshëm në të cilët duhet investuar në shkollim dhe krijim të mundësive për punësim në mënyrë që të merret pastaj nga gjithë energjia pozitive.

Të rinjtë në Kosovë në përgjithësi janë të marginalizuar si produkt i zhvillimeve politiko-sociale dhe ekonomike. Kjo mundësi e angazhimit të të rinjve në jetën publike, përmes procesit të fuqizimit të rolit të tyre në vendimmarrje dhe qeverisje, tregon për shkallën e ultë të demokracisë në institucione dhe jetën publike në përgjithësi.

Dalja e ultë e të rinjve në zgjedhje për shkak mosinteresimit ndaj rrjedhave të përgjithshëm shoqërore nuk i ndihmon procesin demokratik, ngaqë të rinjtë e kanë për obligim që gjithmonë të kërkojnë më shumë transparencë dhe llogaridhënie nga qeveria.

Të rinjtë kryesisht janë të përfaqësuar në nivele të ndryshme të vendimmarrjes në mënyrë simbolike. Opinioni i tyre nuk dëgjohej, këshillat që ofrojnë nuk merren parasysh. Kjo bënë që të rinjtë nuk kanë vetëbesim, kanë frikë që të shprehen lirshëm dhe produktiviteti bie në shkallën zero për shkak të mungesës së menduarit me kokën e tyre. Qeverisja do të përballë me sfidën e krijimit të një shoqërie të informuar ku të rinjtë duhet të luajnë rolin kryesor për shkak të natyrës së problemit. Reformimi i sistemit arsimor është i stopuar përderisa studentët realisht nuk bëhen pjesë e ndryshimit të sistemit arsimor, por luajnë një rol pasiv dhe shumë konformist. Punësimi mbetet problemi më i madh shoqëror sot në Kosovë. Të rinjtë duke qenë në shumicë janë më të prekurit në këtë proces. Fryma e ndërmarrësisë në ekonomi dhe biznes duket së është shumë frytdhënëse për zhvillim ekonomik dhe këtu prap të rinjtë janë të liderë ngaqë janë shumë afër me rrjedhat botërore të udhëheqjes së biznesit. Nga këto të gjitha po shohim se të rinjtë janë hallka më e rëndësishme e shoqërisë e jo strukturë e cila është e “ende e re, e paaftë e paarsimuar dhe jo e gatshme që të përballë sfidat e shekullit njëzet e një.

Të rinjtë kryesisht janë të organizuar në kuadër të forumeve rinore të partive politike, organizatave joqeveritare, lëvizjeve studentore, sektorin e biznesit, media, klubeve kulturore dhe sportive.

Të rinjtë dhe punësimi

Papunësia është një ndër problemet më serioze me të cilat përballlet shoqëria kosovare. Rritja e shkallës së papunësisë në Kosovë ndodh për shkak të problemeve të trashëguara nga e kaluara si dhe nga kriza ekonomike e shkaktuar gjatë periudhës së pas luftës. Problemi i papunësisë bënë që në aspektin afatgjatë të rinjtë të mos kenë mundësinë e marrjes së rolit më aktiv në ndryshimet pozitive shoqërore. Ndryshimet në teknologjinë bashkëkohore kërkojnë një treg të punës më të përshtatshëm dhe më të kualifikuar. Gjëja që më së shumti brengos është numri i madh i të papunëve të pakualifikuar, në kohën që të rinjtë si potencial i marrjes së përgjegjësive nuk e kanë shkollimin kualitativ si dhe konkurrencën jolojale në treg të punës.

Problem tjetër më të cilin të rinjtë ballafaqohen është edhe ndihma financiare për iniciativat e ndërmarrësisë. Mungesa e përvojës në punë bënë që të rinjtë të mos e gjejnë shpesh veten në tregun e punës, ngaqë punëdhënësit janë të interesuar që të punësojnë njerëz me eksperience. Problem që vlen të theksohet është mungesa e dialogut në mes të partnerëve social, qeverisë dhe sektorit të biznesit. Bashkëpunimi gjithashtu mungon edhe ndërmjet sistemit arsimor dhe tregut të punës në përcaktimin e drejtimit që studentët dhe nxënësit zgjedhin në momentin kur përfundojnë me shkollim.

Të rinjtë dhe arsimi

Investimi në arsim është i rëndësishë së veçantë për të ardhmen e Kosovës. Kjo duhet të kihet parasysh kur dihet se më shumë se gjysma e popullsisë në Kosovë janë të moshës rinore. Edhe pse ekziston një potencial i kënaqshëm që mund të shfrytëzohet për zhvillim e gjithëmbarshtëm të vendit, ky potencial nuk duhet të mbivlerësohet dhe të merret si i mirëqenë. Investimi në arsim gjeneron të ardhura më të mëdha në aspektin individual përderisa në aspektin e përgjithshëm shoqëror zhvillimi shoqëror, ekonomik dhe politik ndodh me ritëm më të përshpejtuar. Burimet njerëzore (rinia) duhet të konvertohet në kapital njerëzor që do të thotë burime njerëzore me kualifikime superiore akademike.

Të rinjtë kalojnë të shumtën e kohës në sistemin e arsimit formal ku kërkohet dituri dhe shumë aftësi tjera shoqërore. Sistemi i arsimit në Kosovë ofron shumë informacion por shumë pak në zhvillimin e metodave mbi hulumtime dhe mendimin kritik. Arsimtarët dhe profesorët zakonisht përdorin qasjen e sanksionimit se sa në motivim e tyre. Metodologjia e përdorur në shkolla të mesme dhe universitet është kryesisht e tejkalluar përderisa mjetet teknike janë zakonisht joadekuate. Të gjitha këto probleme reflektohen në cilësinë e arsimit në Kosovë e cila për momentin është larg standardeve evropiane.

Të rinjtë dhe organizatat jo-qeveritare

Zhvillim të hovshëm OJQ-t në Kosovë patën në periudhën e pasluftës duke bërë ngritjen e vetëdijes qytetare mbi aktivizimin qytetar jo vetëm në qytete por edhe në vende të paurbanizuara. Organizatat joqeveritare ndërkombëtare patën një shtrirje të hovshme duke financuar projekte nga më të ndryshmet. Me aktivitetet të ndryshme u bë që OJQ-të të krijojnë një ambient rregullativ për luftimin efikas të dukurive negative që ekzistonin në Kosovë.

Integrimi i komuniteteve nëpër aktivitetet e OJQ-ve tregoi edhe një herë se Kosova është një vend ku do të respektohen të drejtat e të gjithë qytetarëve, barazia gjinore, racore dhe religjioze do të jetë prioritet.

Shtatë vite pas luftës rënia e interesimit të donatorëve për ndihmë materiale është problemi kryesor me të cilat të organizatat rinore joqeveritare ballafaqohen sot. Familjarizimi dhe politizimi i OJQ-ve është një ndër problemet tjera të cilat jorrallë e ka përfshirë sektorin joqeveritar.

Forcimi i bashkëpunimit në mes të sektorit joqeveritar dhe sektorëve të tjera ku të rinjtë kontribuojnë duhet të realizohet. Bashkëpunimi i ndërsjellë do të korrtë rezultate pozitive në projekte trajnimi dhe fuqizimi do të forconte të gjitha sektorët. Që të jetë i suksesshëm i gjithë sektori duhet të ekzistojë një marrëveshje ndër sektoriale në mes të OJQ-ve rinore, forumeve rinore të partive politike, sektorit të biznesit dhe të rinjve të inkuadruar në media.

Të rinjtë dhe kultura

Edhe pse kanë kaluar shtatë vite pas përfundimit të luftës në Kosovë, prapë se prapë problemet në jetën kulturore janë shumë të mëdha, si në teatro, kinematografi dhe kinema, galeri të arteve, salla të muzikës dhe madje në vet fakultetin e arteve të Universitetit të Prishtinës. Ky fakultet funksionin në kushte të mjeruara në mungesë të objektit, sallave, laboratorëve për punë praktike dhe prova për inskenimin e shfaqjeve dhe probleme tjera të shumta.

Përderisa teatrot kanë probleme më financimin e projekteve, aparaturat dhe mjetet teknike për skenografi, inskenim, ndriçim, kostume dhe shumë gjëra të tjera përcjellëse. Dramaturgët, regjisorët dhe aktoret e pakët të punësuar në to, përfitojnë pagë mujore tejet të ultë e shpeshherë edhe me vonesë është shumë e vështirë të përballohet nga një artist profesionist.

Kinematografia ballafaqohet me problemin apo mungesën bazë të industrisë së filmit, prej kamerave filmike profesionale deri tek montazhet, ndriçimi dhe pjesët të tjera përcjellëse filmike, mandej mbështetjen financiare nga institucionet përgjegjëse të cilët nuk qajnë kokën për gjëra kulturore.

Në anën tjetër, problemi më i madh qëndron në faktin se teatrot dhe kinematë përbalën edhe me mungesë të publikut dhe shpesh herë ndodhë të jetësohen vepra artistike në praninë e një numri shumë të vogël shikuesish. Mandej ekspozita të pa vizituara, opera dhe vepra artistike muzikore të pa dëgjua etj.

E gjithë kjo parregullsi dhe varfëri në kulturën e përgjithshme dhe institucionet kulturore, shfrytëzohen nga individ të caktuar dhe kompani të ndryshme amatoreske të bazuara mbi profitin në radhë të parë dhe vlerat artistike në radhë të dytë, duke i servuar dhe argëtuar të rinjtë me gjëra të pa pavlera: muzikë kiç dhe shund, muzikë të vjedhur, muzikë që imponon dhe përdhunon ndjenjat, drama televizive dhe humor banal, organizime të ndryshme si: pishina-party dhe diskoteka-party ku të rinjtë mundohen ta gjejnë vetën përmes alkoolit dhe drogave të ndryshme që ti lënë anash brengat dhe streset që ju rendojnë mbi kokë .

Rinia "Aleanca Kosova e re", ka vizion të qartë se si ti luftoj dukurit negative në kulturën e përgjithshme dhe ti orientoj të rinjtë kah vlerat artistike: teatrot, kinematë, ekspozitat, operat dhe koncerte të tjera të veprave artistike muzikore, duke i shkëput ata nga rutina dhe monotonia e përditshme dhe përnatshme në klubet dhe diskotekat e vendit.

Rinia "Aleanca Kosova e re", punën e saj do ta filloj me hulumtimin e shkaqeve dhe pasojave nëpërmjet filmit dokumentar në të gjitha fushat e artit, ku me ç'rast do të identifikohen problemet dhe pastaj do të filloi fushatën e saj, prej debateve mbi artin dhe kulturën e përgjithshme, koncertet artistike në bashkëpunim me Filharmoninë dhe studentët e muzikës, ekspozita, shfaqjeve teatrale dhe kinematografin dhe aktivitete të ngjashme kulturore me qëllim të ngritjes së nivelit kulturor, kthimin dhe orientimin e të rinjve-publikut drejt vlerave artistike, të bukurës së artit që njëherit

është e lidhur ngushtë me shpirtin dhe ndjenjat dhe ngrit moralin njerëzor, ndrit mendjen e njerëzve mbi kuptimësiminë e jetës dhe botës.

Të rinjtë dhe migrimi (rrjedhja e trurit nga Kosova)

Largimi i njerëzve nga Kosova drejt vendeve të zhvilluara është një fenomen i njohur për ne. Ishin fillim vitet e 90-ta të shekullit të kaluar kur ky largim po zhvillohej masovikisht dhe në këtë kohë ishin të pakët ata qytetar të Kosovës të cilëve po t'u ipej një mundësi e tillë për largim që nuk do ta shfrytëzonin, sepse ishin kushtet ekonomike, sociale dhe sidomos ato politike që ta impononin një gjë të tillë. Shumica nga ata që po largoheshin nga ky vend ishin të rinjtë të cilët nuk po e gjenin vetën në situatën e krijuar në vend (pa mundësi shkollimi dhe pa punë). Shumë nga ata që shkuan në vendet më të zhvilluar më sakrificë shumë të mëdha u arsimuan dhe krijuan emër që shumë kush do t'ua kishte zili. Dhe më lirinë e Kosovës u kthyen edhe shumë të rinj që ishin diplomuar nëpër universitetet e ndryshme botërore. Por, euforia e pas luftës nuk zgjati shumë dhe ata prapë ikën apo po ikin, por kësaj here të shoqëruar edhe më shumë bashkëmoshatarë të tyre e fatkeqësisht më këtë po ik edhe 'truri' i Kosovës. Kjo po ndodh për shkak të gjendjes së rënd ekonomike dhe sociale, por edhe për shkak të një vlerësimi të pakët që po iu bëhet intelektualëve. Kushtet e vështira për të studiuar në Universitetin tonë apo edhe cilësia e dobët në studim janë edhe një shtysë tjetër për ata që synojnë të arrijnë diçka në jetë.

Është mallëngjyese sot të shkosh dhe të shikosh para përfaqësive të huaja diplomatike që ndodhen në vendin tonë, sepse atje do të shikosh më qindra të rinj që presin para dyerve të tyre (përfaqësive diplomatike) duke shpresuar se do të kenë fat dhe do ta marrin një vizë. Po ashtu ka edhe shumë të tjerë që bëjnë martesë të sajura më të dashurat e shokëve apo edhe vëllezërve të tyre vetëm për të siguruar një hyrje legale në 'tokën e premtuar'. Dhe, nga ata të rinj shumica janë student apo edhe të diplomuar që nuk kishin fatin që në administratën shtetërore apo në ndonjë pozitë tjetër të kenë një të afërm të tyre që tu ndihmonte për të siguruar një vend pune.

Ky fenomen, pra largimi i trurit nga Kosova është kërcënimi më i madh në planin afatgjatë për vendin tonë. Por, FR AKR-ja më ndihmën e pakursyer edhe të AKR-së dhe strukturave më të larta të saj do të bëjë projekte në të cilat do të fokusohet në 'thithjen e trurit' dhe do ta luftoj 'rrjedhjen e trurit'. Luftimi i këtij 'eksportimi të trurit' do të bëhet më anë të mekanizmave të duhur institucional dhe duke mos i cenuar asnjëherë parimet e demokracisë (garantimi i lëvizjes së lirë të njerëzve, ideve, kulturave, etj.). Edhe ata janë pjesë e ardhmërisë sonë, edhe ata meritojnë një tretman të duhur dhe kushte më të mira për të jetuar në Kosovë.